REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 TË BASHKISË SHKODËR"**

**Konsultim publik** : Njësia administrative: Gur i Zi.

**Data** : *16.09.2025* **Ora** : *13.00* **Vendi:** *Pranë Komunës.*

**Numri i pjesëmarrësve** : *Numri i pjesmarrësve 37, nga të cilat 7 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : *Për draft-projekt planin buxhetor afatmesem 2026-2028 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës** : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Zv.Kryetarja e Bashkisë Shkodër, e cila bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :**

Takimin e hap administratori i njësisë administrative **Z. Vitor Hila**, i cili falenderon pjesëmarrësit për interesin e treguar dhe i fton ata që të paraqesin problematikat dhe shqetësimet e tyre duke vendosur me prioritet për ato punë që mund të realizohen. Ai shton se dihet që kemi një sërë nevojash dhe buxheti duhet të jetë shumë i madh por është e rëndësishme të vendosim prioritetet për ato punë që janë më emergjente për tu realizuar.

Edhe **Zv.Kryetarja e Bashkisë Znj.Qyteza** falënderon të pranishmit për të qenurit aktiv në këto takime. Kjo tregon, shton ajo edhe besueshmëri tek Bashkia dhe punët që realizojmë së bashku.

Bashkia është shumë e interesuar që çdo zonë të jetë në fokusin e saj sipas nevojave që janë në terren, riparime infrastrukture, kanale kulluese e ujitëse e një sërë punësh të tjera që duhen të bëhen bashkarisht. Ajo gjithashtu shton se për një kohë shumë të shkurtër kemi arritur të bëjmë pune të mira dhe mirëpresim nga ju propozimet për buxhetin e Bashkisë. Kjo zonë është shumë e gjallë nga ana e biznesit dhe nga impakti direkt që ka në Shkodër.

Një gjë e rëndësishme është edhe diskutimi për të ardhurat dhe shpenzimet e zonës që siç e dini ato kthehen në investime për njësinë tuaj.

**Z. Gezim Lahi,** kryetari fshati Gurit i Zi:

- Rruga e varrezave myslimane nuk është realizuar akoma, është edhe rrugë që lidh dy fshatra Gurin e zi dhe Jubanin
- Qendra e Gurit të zi nuk ka asnjë trotuar dhe fëmijët që shkojnë në shkollën aty pranë njësisë janë të rrezikuar. Duhet të ketë një trotuar afër kësaj shkolle.
- Ndriçimi në Gurin e zi nuk është aspak i mirë, janë me shtylla të posacme dhe ketu kemi ndriçuesit në shtylla elektrike dhe nuk kanë as estetik dhe nuk janë as funksionale.

**Kryetari, fshatit Kuq:**

- Ka nevojë për ndërhyrje rreth 100 metra nga rruga kryesore deri tek varrezat .
- Po ashtu janë 300-400 metra kanal në zonën e fshatit Kuq, që duhet të kontrollohen.

**Kryetari, fshati Shpor:**

- Rruga e Mazrekut prej në Gjec dhe deri në Shpor ka nevojë për mirëmbajtje me cakull e stabilizant nga ana e Bashkisë.

**Z. Bahri Osmani,** kryetar, fshatit Vukatan:

- Janë dy rrugë në fshatin tonë që kanë nevojë për ndërhyrje, ajo nga hekurudha tek varrezat në Vukatanë.

**Z. Valon Mali,** kryetar fshati Ganjoll:

- Kemi një rruge të fshatit, me rreth 35 familje që kur bie shi është e pakalueshme rreth 400 metra e gjatë. Madje jemi mbledh edhe së bashku si komunitet dhe kemi mbledhur edhe fonde për ta shtruar bashkarisht këëe rrugë..
- Kanali vaditës në Ganjollë që është në përdorim nga gjithë fshati ka nevojë për vëmendje.
- Një tjetër problem për zonën Ganjollë është se nuk kemi më vend varrezash . Edhe në varrezat ekzistuese ka gjithmonë prezencë uji.

**Z. Zef Markaj,** banor lagjja Kavaç, Ganjoll:

- Jemi rreth 35 shtëpi dhe është kërkesë e vazhdueshme dhe lutemi që të na asistoni dhe ta bashëfinancojmë rrugën që u përmend më lart.

**Z. Klaudio Haxhari,** banor fshati Rragam:

- Përroi i Pistallës më shumë ka dëmtuar se ka sistemuar dhe akoma nuk është zgjidhur asgjë.Ky investim ka bërë një sërë problemesh në zonë, prandaj duhet riparë.
- Gjithashtu duhet të rishihet edhe asfaltimi i rrugës në rragam që shkon pranë bizneseve.
- Duhet të ndërhyhet në kanalet vaditëse.
- Në Rragam duhen riparuar gropat e rrugës kryesore.
- Duhet të ketë edhe një urë këmbësorësh që lidh përroin e Pistallës me lagjen aty.
- Duhen prerë ferrat edhe në Rragam.
- Gjithashtu shkolla në Rragam, këndin sportiv e ka të përmbytur në ujë dhe tualetet i ka kolektive.

**Kryetari i fshatit Gajtan:**

- Tre rrugica në Gajtan kanë nevojë për asfaltim.
- Ndriçimi në Gajtan ka nevojë edhe për një ndërhyrje të vogël sepse pjesa me e madhe është bërë.

**Kryetari i fshatit Rrenc:**

- Fusha e futbollit në Rrenc ka nevojë të investohet në mirembajtje. Fusha është ekzistuese dhe nuk ka parametrat e FSHF-shë por mund të investohet në shërbim të komunitetit.
- Në fshatin tonë nuk kemi rrugë për në varreza.

**Drejtoresha e shkollës Guri i Zi:**

- Shkolla e Gurit të Zi është e degraduar nga ana e infrastrukturës, tualete të shkatërruara, ka pasur vetëm ndërhryje sporadike. Dhe është ndër shkollat më të mira të Shkodrës.
- Duhet parë edhe planifikimi i furnizimit të mjeteve të kancelarisë dhe pastrimit, pasi janë të gabuara dhe vijnë edhe me mungesë.

**Z. Eduard Jaka , kryetar fshati Sheldi:**

- Në fshatin Sheldi nuk kemi ujë të pijshëm.
- Ka nevojë për ndërhyrje në rrugë, pasi nuk kemi asnjë rrugë në fshat.
- Nuk kemi qendër shëndetësore.
- Duhet vënë dorë në kanalet vaditëse.
- Jemi edhe papunë dhe duam të punësohemi që t'i shërbejmë zonës tonë.

**Kryetari i fshatit Juban**

- Sistemi i ujit të pijshëm nuk funksionon.
- Rrugët janë inekzistente dhe nuk kemi asnjë investim për rrugët.

- Për kanalin vaditës sipër Jubanit duhet medeomos të vijohet puna dhe te mbyllet vaditja për këtë zonë.

**Drejtoresha e kopshteve Guri i Zi:**

- Në zonë kemi 5 kopshte me 120 fëmijë dhe kemi akoma rregjistrime dhe kopshte të hapura.
- Infrastruktura është e keqe, tualetet jaëe të përbashkëta mes fëmijeve dhe nxënësve të kopshtit. Prandaj duhet të mendohet një zgjidhje për të gjitha kopshtet për një ndërhyrje për këëe problematike, përvec kopshtit të Jubanit, i cili është bërë sipas çdo parametri dhe sot shohim që ka rritje të numrit të fëmijëve dhe frekuentimit.
- Kemi edhe 40 fëmijë që frekuentojnë kopshtin e Gurit të Zi, mund të bëhet një ndërhyrje dhe ndarje e hyrjes së tij nga shkolla.
- Më emergjente është kopshti në Kuç, që perveç çatisë së rregulluar ka rrezik të përhershëm të përmbytjes. Po ashtu ka nevojë për rrethim dhe të sigurohet nga kanali që ka pranë, i cili e përmbyt. Edhe tavani është i shkatërruar.

**Banor, fshati Vukatanë:**

- Kemi nevojë që rrugicat e fshatit të shtrohen ose mirëmbahen.
- Në lidhje me varrezat, duhet bërë hapja e tokës së re.
- Ndriçimi në Vukatanë duhet të shtohet.
- Një kanal vaditës që është bërë duhet të këtë hapje të daljeve të reja.

**Z. Agron Ymeri:**

- Në lagjen tonë kemi rreth 500 metra rrugë që duhen shtruar.
- Duhet bërë sistemimi i përroit pranë xhamisë.
- Me OSHEE kemi problematikë të vazhdueshme nga rrjeti elektrik i amortizuar në Rragam , Kuq e në fshatrat e tjerë.

**Z. Mehmeti,** lagjja Ferracake :

- Duhet ndërhyrë në rrugën e varrezave, që lidh fshatin Gur i Zi dhe lagjen Ferrecake me varrezat.

**Z. Bledar Isufi, fshati Gajtani**:

- Të mbikqyren këto firmat që bëjnë punimet sepse bëjnë punë të dobta. Duhen riparë asfaltimet e kryera dhe ndërhyrja në gropat e hapura.
- Kanali vaditës gjithashtu është i dëmtuar dhe ka pasur shumë probleme.

**Banor, fshati Guri i Zi:**

- Fusha e Gurit të Zi nuk ka kanal vaditës, dhe i gjithë uji i Pistallës shkon më kot ndërkohë që mund të shfrytëzohet sepse nuk ka kanal në këtë zonë. Është shumë i nevojshëm sepse ka banorë që duan të punojnë në ferma por pa ujë nuk punohet.
- Kemi rrugën Veli Karma, e cila në pjesën më të madhe është bere me kanalizime e të gjitha dhe ka nevojë vetëm për asfaltim.
- Ujësjellësi në Rragam nuk funksionon, dhe janë rreth 1300 banorë pa ujë.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka **Znj.Teuta Qyteza,** Zv.Kryetare e Bashkisë mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

**SEKRETARE**

___________________________

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**LISTË PREZENCË**
***( Njësia Administrative Gur i Zi )***

**KONSULTIM PUBLIK: "Për Miratimin e Projektbuxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Shkodër"**

***Datë:* 16.09.2025**

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Mirela Pjetrani | Guri Zi | 0674086189 | mirelapjetrani@gmail.com | [signature] |
| 2. | Jemin [illegible] | Gur. Zi | 0696359396 | | [signature] |
| 3. | GERGI GJONI | GUBAL | 0687737220 | | [signature] |
| 4. | Anton [illegible] | Gur'Zi | 069.6762220 | | [signature] |
| 5. | Gzelin Hoxha | Rragam | 0682781916 | | [signature] |
| 6. | Bahri Osmani | Vukatan | 0675528326 | | [signature] |
| 7. | Samir Guri | Vukatane | 0692400039 | Erxhamgur@gmail | [signature] |
| 8. | Besim Selimi | Guri Zi | 0693312812 | | [signature] |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 9. | Xhevahir Lohi | Guri Zi | 0693561825 | | [signature] |
| 10. | DRITAN ISUFI | ~~Guri Zi~~ GAJTAN | 0683333200 | | [signature] |
| 11. | Eduard Jaku | SHELDI | 0684444653 | | [signature] |
| 12. | DENIS ZEFI | SHELDI | 0682192306 | | [signature] |
| 13. | Artur Meti | Kuç | 0692932298 | | [signature] |
| 14. | Saloh Vraji | Gaujolle | 0695796394 | | [signature] |
| 15. | Pllum Kolea | Gontoll | 0692533814 | | [signature] |
| 16. | AFRIM TAHIRI | GAJTOLL | 0694723946 | | [signature] |
| 17. | Kloudio Hoxhari | Rragam | 0686277385 | | [signature] |
| 18. | Gëzim Lohi | Guri Zi | 0699493893 | | [signature] |
| 19. | Arben Lunaj | RRENC | 0694145922 | | [signature] |
| 20. | Mirash Gosaj | Shpall | 068357007 | | [signature] |
| 21. | Nik Gjonlulaj | MAZRAEK | 0688948004 | | |
| 22. | Tom Noloa | Guri Zi | 0694420715 | | |
| 23. | Elsaid Duli | Vukatanë | 0684713143 | | [signature] |
| 24. | Sondey Cozri | Juban | 0673794451 | | [signature] |
| 25. | Frano Yoki | Juban | 0682166841 | | [signature] |
| 26. | Hyrietë Bushaj | Guri Zi | 0684476652 | | [signature] |
| 27. | Amine Nikolli | Guri Zi Dr.09 | 0690052656 | | [signature] |
| 28. | Roland Zhala | Guri i Zi | 0692022800 | | [signature] |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 29. | Enxhi Vosa | Guri i zi | 0683079669 | enxhivosa18@gmail.com | [signature] |
| 30. | Arlinda Kruja | Bahçallëk Shkodër | | | [signature] |
| 31. | Nomela Kola | Besnikë Shkodër | 0673570001 | nomelakola@besnike.al | [signature] |
| 32. | Flavio Malocaj | Besnikë Shkodër | 0684063501 | | [signature] |
| 33. | Kino Sheldija | DPMOP | 0696411374 | | [signature] |
| 34. | Alban Salihi | NSHPP | 0672042990 | | [signature] |
| 35. | Jozef Noloçaj | D. Mjedës, T | 0692458711 | ndoni.jozef@gmail.com | [signature] |
| 36. | Ilir Toli, T. | B. Shkodra | — | | [signature] |
| 37. | Paulin Usimani | Luban | 0695138470 | | [signature] |
| 38. | | | | | |
| 39. | | | | | |
| 40. | | | | | |
| 41. | | | | | |
| 42. | | | | | |
| 43. | | | | | |
| 44. | | | | | |
| 45. | | | | | |
| 46. | | | | | |
| 47. | | | | | |
| 48. | | | | | |